

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-26-852-1-1-1 / KEKC-26-108-111**

Sa i përket tenderit për **Blerja dhe instalimi i rotorëve te pompave furnizues**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ZILONIS Energy Solutions GmbH – i autorizuar nga GOE
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Nisterfeld 11
(Adresa)

Müschelbach, Germany
(Vendi)

57629
(Kodi postar)

+49 2662 500 44 0
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Musa Smakaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

msm@zilonis.de
(Adresa elektronike)

06.08.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)


ZILONIS®
ZILONIS Energy Solutions GmbH
Nisterfeld 11, 57629 Müschelbach
www.zilonis.de
+49 (0) 2662 50044-0
support@zilonis.de
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për Kontratë - 16.04.2026
- Përgjigje ne Pyetje nga OE't – 07.05.2026
- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara - 14.05.2026
- Njoftim per zgjatjen e datës se dorëzimit te ofertave – 14.05.2026
- Proces verbali i hapjes se Tenderve – 29.05.2026
- Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 16.07.2026
- Leter Standarde per tenderuesin e eliminuar – 16.07.2026
- Kerkes per qasje -17.07.2026
- Dhenje e qasjes -17.07.2026
- Kerkesa per rishqyrtim 21.07.2026
- Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim nga ana e AK 27.07.26.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën 16.07.2026 kemi pranuar letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar. Me date 21.07.2026 kemi dërguar kërkesë për rishqyrtim duke argumentuar ne detaje shkeljet e AK ne rastin e eliminimit tone si dhe anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit. Me date 27.07.2026 kemi pranuar përgjigje ne kërkesën tone për rishqyrtim, përgjigje sipas te cilës refuzohet kërkesa jone për rishqyrtim ne tërësi, refuzim me te cilin AK me ngulm mbron shkeljet e evidentuara nga ana jone. Ku ne pretendojmë se vetëm me shume AK ka konfirmuar se ne kemi te drejte pasi refuzimin e ka bere duke forcuar aludimet e evidentuara.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Shkelje e nenit 1 Qëllimi,
- Shkelje e nenit 4 Përkufizimet,
- Shkelje e nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi,
- Shkelje e nenit 28 Specifikimet teknike,
- Shkelje e nenit 51 par. 1, 2 pika (ii) dhe 3 te LPP-se, Kriteret të Përzgjedhjes,
- Shkelje e nenit 56 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe pika 3 te LPP-se, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,
- Shkelje e nenit 59 te LPP-se, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
- Shkelje e nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,
- Shkelje e nenit 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve,
- Shkelje e nenit 72 Dispozitat e Përgjithshme

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabje shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Ne si GOE, pas lejitimit të qasjes në dokumentet e DT nga ana e AK me datë 16.07.2026, kemi përgatitur dhe dorëzuar pranë AK kërkesën për rishqyrtim bashkëngjitur si ANEKS 1 kësaj Ankesës, ku kemi ngritur pretendimet tona dhe kemi argumentuar shkeljet e AK në raport me vlerësimin e ofertës sonë dhe kemi argumentuar se AK ka keqinterpretuar kriteret e DT dhe ligjin e prokurimit me qëllim eliminimin tonë si GOE i vetëm ofertues në këtë procedurë. GOE të cilit i prinë si lider konzorciumi vete prodhuesi autentik i pompës STORK-Bilfinger, pajisje për të cilën edhe është iniciuar procedura tenderuese nga ana e AK.

Me poshtë të listuar shkeljet nga ana e AK gjatë procesit të shqyrtimit të pretendimeve tona në kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimi ynë numër 1

I. SHKELJA E NENIT 56 dhe 59 TË LPP-së 2024

– Shpallja arbitrarë e Aneksit 7 si "i pavlefshëm" dhe injorimi i autorizimit ligjor:

- Nënshkrimi i Titullarëve Ligjorë: Aneksi 7 (Deklarata mbi Themelimin e Grupit-pjese e ofertës baze) është nënshkruar dhe vulosur në mënyrë absolute nga përfaqësuesit LIGJORE DHE STATUTORË të secilës kompani në faqet 3 dhe 4 (Richard Evert Reinier van Essen për Bilfinger, Musa Smakaj për ZILONIS, dhe Kushtrim Hasanaj për AVK Power). Vullneti juridik i korporatave është konsoliduar plotësisht dhe pa asnjë ekuivok.

- Legjitimiteti i z. Arben Ejupi: Nënshkrimi i z. Arben Ejupi në rubrikën e fundit është plotësisht i mbuluar nga aktet korporative. Sipas dokumentit zyrtar "Official Confirmation" të datës 06/03/2025, Stork Pompen (Bilfinger) ka konfirmuar zyrtarisht se Zilonis Energy Solutions GmbH - Dega në Kosovë, e përfaqësuar nga z. Arben Ejupi, është partneri zyrtar për bashkëpunim, servis dhe inspektim të pompave Stork në Kosovë me vlefshmëri deri më 06/03/2028. Komisioni ka pasur para vetes një person të autorizuar zyrtarisht nga vetë prodhuesi, andaj eliminimi mbi pretendimin e mungesës së një autorizimi formal për asistencë administrative përbën kapriço të pastër dhe shkelje të Nenit 41 të Rregullores 02/2024, pasi nuk ka asnjë devijim material.

Për me tepër dëshmi për këtë është edhe dokumenti bashkangjitur ne ofertën e dorezuar ku z. Arben Ejupi përfaqëson ZILONIS GmbH përmes degës se saje ne Kosove, Bilfinger Thermeq BV për territorin e Kosovës, dokumenti nen emërtimin **"17. Collaboration Stork & Zilonis"**. dhe ky autorizim është aktiv deri me 06.03.2028.

Përgjigje

Ju pretendoni se eliminimi i ofertës është i paligjshëm pasi nënshkrimi i z. Arben Ejupi në Aneksin 7 (Deklarata mbi Themelimin e Grupit) mbulohet nga dokumentet korporative dhe dokumenti "Official Confirmation / 17. Collaboration Stork & Zilonis" (me vlefshmëri deri më 06.03.2028). Sipas jush, ky dokument provon se Zilonis Energy Solutions GmbH - Dega në Kosovë është partner zyrtar i kompanisë Bilfinger, dhe se për sa kohë titullarët e tjerë ligjorë e kanë nënshkruar dokumentin, vullneti juridik i grupit Autoriteti Kontraktues i refuzon të gjitha pretendimet e juaja si të pabazuara në ligj, mbi këto arsye juridike dhe administrative:

- Dokumenti i dorëzuar në ofertë me titull "Collaboration Stork & Zilonis" paraqet vetëm një marrëveshje tregtare e teknike bashkëpunimi për shërbime, servis dhe inspektim. Kjo marrëveshje nuk përbën Autorizim i Posaçëm Ligjor. Një marrëveshje e thjeshtë bashkëpunimi komercial nuk i jep asnjë të drejtë z. Arben Ejupi që të përfaqësojë, të zotojë apo të marrë obligime juridike e financiare në emër të entiteteve të tjera (siç është Bilfinger) për procedurat e këtij aktiviteti.
- Aneksi 7 (Deklarata mbi Themelimin e Grupit të OE) është dokumenti bazë zotues ku anëtarët e konsortiumit marrin përgjegjësi solidare dhe të përbashkëta para Autoritetit Kontraktues. Nënshkrimi i këtij dokumenti në rubrikën "Përfaqësuesi i Autorizuar" nga një person (z. Arben Ejupi) i cili nuk është përfaqësues ligjor i asnjërit prej anëtarëve të grupimit dhe për të cilin nuk është prezantuar asnjë autorizim me shkrim në ofertë, e bën këtë dokument juridikisht të pavlefshëm dhe të paefektshëm.
- Pretendimi i ankuesit se kjo përbën një lëshim të vogël administrativ sipas Rregullores së Prokurimit nuk qëndron. Nënshkrimi i dokumenteve zotuese nga persona të paautorizuar ligjërisht përbën devijim esencial e material nga kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në bazë të Nenit 59, Paragrafi 2 të LPP-së,

Autoriteti Kontraktues e ka obligim ligjor të shpallë të papërgjegjshme çdo ofertë që nuk i përmbush kërkesat formale dhe juridike. Pranimi i një dokumenti të tillë pa autorizim përkatës do të cenonte rëndë Parimin e Trajtimit të Barabartë (Neni 7 i LPP-së).

Ne këtë përgjigje AK injoron çdo argument të prezantuar dhe bazës ligjore, duke i dhënë të drejte vetes në interpretim dhe aludim dëshirore të kësaj pike. Duke injoruar faktin se ne oferte është dorëzuar Aneksi 7 në përputhje me kriteret e kërkuara në DT dhe se autorizimi i personit të përcaktuar nga GOE është bere në pajtim të plote nga të gjithë përfaqësuesit ligjorë të OE-ve ku të njëjtin me vullnet të lire dhe me vetëdije të plote kanë autorizuar përfaqësuesin e tyre.

II. PROVA ABSOLUTE (SHKELJA E NENIT 7 DHE 28 TË LPP-së) – Eliminimi i vetë pasardhësit ligjor të Prodhuesit Original (STORK)

- Identiteti i Njëjtë Juridik (Bilfinger = Stork): Pretendimi i AK-së se oferta nuk përmban dokumentacionin apo autorizimin e "prodhuesit" është një lajthitje trashanike dhe faktike. Sipas dokumentit zyrtar të njoftimit të datës 15 Tetor 2025, kompania prodhuese origjinale STORK THERMEQ B.V. ka ndryshuar emrin e saj ligjor në BILFINGER THERMEQ B.V. me efekt nga 29 Tetor 2025. Ky dokument specifikon në mënyrë të prerë se Numri i Regjistrimit të Dhomës së Tregtisë (CoC 63343851) dhe Numri i TVSH-së (VAT NL855195551B01) MBETEN TË NJËJTË DHE TË PAPREKUR. Rrjedhimisht, Lideri i GOE, Bilfinger Thermeq B.V., nuk është një palë e tretë, por ËSHTË VETË PRODHUESI ORIGJINAL STORK nën emrin e ri korporativ. Eliminimi i ofertës me arsyetimin se nuk kemi ofruar autorizim nga prodhuesi do të thotë se AK-ja ka eliminuar vetë Prodhuesin e Pajisjes, gjë që është ligjërisht absurde.

Dëshmi e bashkangjitur ne oferte dokumenti nën emërtimin:

“3. Authenticity of the Products_Stork.Bilfinger”

“16. Letter clients Thermeq name change”

- Konsistenca e Përfaqësimit: Letra zyrtare e ndryshimit të emrit korporativ nga Stork në Bilfinger është nënshkruar nga z. Richard van Essen (Vice President BU Mechanical). I njëjti autoritet ligjor, z. Richard Evert Reinier van Essen, ka nënshkruar ofertën tonë dhe marrëveshjen e GOE. Vullneti juridik është 100% i konsoliduar.

- Inkonsistenca e AK gjatë vlerësimit në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit: Në shënimet sqaruese të Tabelave 4.1.1 dhe 4.1.2.1 të vetë Dosjes së Tenderit, KEK sh.a. deklaron zyrtarisht: "Vizatimet detaje të këtyre pjesëve nuk posedohen në arkivin e Termocentralit Kosova B". Në një situatë ku vetë Autoriteti Kontraktues pranon që nuk i posedon këto vizatime, kërkesa që një OE t'i dorëzojë ato si kriter eliminues në fazën e ofertimit, për më tepër kur përballë ka vetë prodhuesin e këtyre pompave që i disponon ato ekskluzivisht për fazën e prodhimit/ekzekutimit, përbën shkelje të hapur të Nenit 7 të LPP-së (Trajtimi i Barabartë dhe Jo-Diskriminimi) dhe tentativë absurde jashtë kriterëve kualifikues të saktësuar në dosjen e tenderit. AK nuk ka të drejtë të eliminojë asnjë OE për kriter apo kërkesa kualifikuese që nuk ishin pjesë e tender dosjes.

Për më tepër AK bene loje fjalësh ku vete ne DT shkruhet qe OE **“duhet te dëshmoi se posedon dokumentacionin teknik te detajuar me dimensione te punëtorisë dhe material te kërkuar për prodhimin rotorëve dhe pjesëve rezerve te kërkuara ne projekt”** po ashtu **“duhet ta deklaroj pajisjen te cilën do ta përdor për përmirësimin e sipërfaqes se brendshme te shtëpizës se pompave furnizuese si dhe stafin i cili do ta angazhoj te operoi me këtë pajisje”**

Dhe vete AK deklaron ne DT:

Shenim: KEK-u, si Autoritet Kontraktues, ne arkivat e veta nuk i posedon vizatime e detajuara te punë specifikuara me material adekuat për prodhim te pjesëve rezerve te kërkuara ne tabelën me lartë. Kështu operatori i interesuar ekonomik duhet te gjej forma për ti siguruar këto dokumente (vizatime) te prodhu origjinal i pompave furnizues te kaldajës te tipit **5BA2M58**.

Prandaj, përgjegjshmërinë e ofertës tone si GOE, e plotëson fakti se pjesë e grupit dhe ne cilësinë e liderit është vet prodhuesi i pompës i cili është autor dhe gëzon te gjitha te drejtat mbi pronësinë e çdo detaji qe lidhet me pompën, duke shmangur dilemën potenciale se si ofertues nuk arrin te realizoi këtë kontrate sipas kërkesave te DT.

Për me tepër GOE ka prezantuar me oferte dokumentet përmes se cilave sqaron dhe plotëson kërkesën e DT siç janë:

“3. Authenticity of the Products_Stork.Bilfinger”

“4.Photos Reference Projects compressed” – shpjegim, perderisa nuk eshte specifikuar eksplisit forma dhe formati i deklarates kete pike referuar DT - 9.1&9.2. ne si GOE kemi ofruar shpjegim nga vendengjarja per te gjithë procesin e trajtimit te pompes duke ofruar per AK me shume se qe kerkohet sipas kerkeses kualifikuese. Ku ne te gjitha etapat eshte dokumentuar procesi permes fotove.

“5.Presentation Product Samples.Facilities.Tools.Photos” – shpjegim, perderisa nuk eshte specifikuar eksplicit forma dhe formati i deklarates kete pike referuar DT - 9.1&9.2. ne si GOE kemi ofruar nje prezantim me 384 faqe ilustrime, spjegime te historikut, spjegime te teknologjise dhe metodologjise se aplikuar, kapacitetet teknike dhe punetore te shumta. Duke dhene sqarime dhe informata te bolleshme, te cilat nga komisioni profesional do duhej jo vetem te trajtoheshin si te pranueshme por edhe te sherbejne si shembull dhe ilustrim per projekte te ardheshme.

“12. Resumes of Key Personnel Bilfinger.Stork”

“16. Letter clients Thermeq name change”

Përgjigja e AK:

2. Pretendimi

KEK-u nuk i posedon vizatimet e detajuara të punëtorisë, kështu që OE duhet të gjejë forma për t'i siguruar këto dokumente nga prodhuesi origjinal...

Përgjigja

Komisioni qëndron plotësisht prapa vlerësimit zyrtar. Operatori Ekonomik në ofertën e tij nuk ka dëshmuar se posedon dokumentacionin teknik të detajuar (me dimensione punëtorie dhe specifikim të materialit të kërkuar për prodhimin e rotorëve dhe pjesëve rezerve).

Me këtë rast, OE-ja nuk ka plotësuar kërkesat minimale teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT), përkatësisht pikat 9.1 & 9.2 (Pika 4) mbi kërkesat e kapacitetit teknik dhe/ose profesional.

Me vetëdije të plote AK injoron dhe anashkalon dokumentet e prezantuara nga GOE dhe vete prodhuesi i pajisjes. Për me tepër e thjeshtojnë arsyetimin duke u thirrë në mos plotësim të kërkesave minimale. Dhe nga përgjigja të jepe përshtypjen se GOE nuk ka prezantuar asnjë dokument. Ndërsa injoron faktin se janë prezantuar mbi 500 faqe dëshmi të dokumentuara për kapacitetin, metodologjinë dhe teknologjinë e punës së GOE dhe vete prodhuesit. Dhe vijon.

3. Pretendimi

Obligimi për Sqarim (Neni 72 i LPP-së dhe Neni 38 i Rregullores 02/2024).Eliminimi direkt pa kërkuar sqarim dëshmon tendencën e Komisionit për eliminim...

Përgjigja :

Aplikimi i Nenit 72 të LPP-së është e drejtë e AK-së për sqarimin e dokumenteve ekzistuese dhe nuk mund të përdoret për të plotësuar dokumente apo kërkesa teknike që mungojnë tërësisht në ofertë.

Eliminimi i OE-së ka ardhur si pasojë e mos përmbushjes së kërkesave esenciale: OE-ja nuk ka deklaruar pajisjen që do të përdoret për përmirësimin e sipërfaqes së brendshme të shtëpizës së pompave furnizuese, si dhe nuk ka deklaruar stafin që do të operojë me këtë pajisje. Rrjedhimisht, OE-ja ka dështuar të përmbushë pikat 9.1 & 9.2 (Pika 5) të Dosjes së Tenderit. Sqarimet shtesë nuk mund të mbyllin dështimet esenciale të ofertës teknike.

Duke injoruar faktin se GOE ka prezantuar dokumentet e kërkuara në DT dhe se në asnjë rast nuk kemi kërkuar plotësim të dokumenteve ekzistuese. AK me vetëdije manipulon dhe bene loje fjalësh duke interpretuar në mënyrë dëshirore trajtimin jo të drejtë të dispozitës ligjore, me qëllim arsyetimin e shkeljes së tij nga ana e AK.

4. Pretendimi

Prodhuesi Bilfinger Thermeq B.V. – STORK ka dhënë sqarime shtesë, komisioni ka injoruar faktin se në ofertë është vetë prodhuesi...

Përgjigja

Vlerësimi i ofertave bëhet ekskluzivisht në bazë të kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar brenda afatit të ofertimit. Edhe pse Komisioni nuk e ka skualifikuar OE-në mbi bazën e kapaciteteve të përgjithshme të kompanisë, vlen të theksohet se në dokumentacionin e dorëzuar në këtë ankese nga OE:

- Në listën e referencave 5-vjeçare nuk është dëshmuar kryerja e punëve në pompa furnizuese të kaldajës të tipit të kërkuar (5BA2M58).
- Në CV-të e stafit profesional nuk është dëshmuar përvojë apo udhëheqje e punëve në këtë tip specifik pompash.

Prandaj, pretendimet se emri i prodhuesit automatikisht zëvendëson mosplotësimin e kriterëve të specifikuar në DT janë teknikisht të paqëndrueshme.

E në vijim të përgjigjes prapë AK manipulon, mbivendosë kriterë të cilat nuk janë pjesë e DT të cilat janë të shpikura në qaste vetëm për të mbuluar dhe arsyetuar manipulimin e mëparshëm në vlerësim. Ku me një mënyrë tendencioze pretendon se në listën e referencave është kërkuar reference për kryerjen e punëve në pompën specifike të tipit “**(5BA2M58)**”. Kërkesë e cila në DT referuar FDT pika 9.1&9.2 referuar si më poshtë në screenshot, ku në asnjë rast dhe në asnjë shkronjë të vetme AK nuk ka vendosur këtë kriter. Andaj kjo përbënë një shkelje të rëndë dhe të qëllimshme dhe tendencioze duke mbivendosur kriterë eliminues në këtë fazë.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1. Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë reprezentues 2. Projektet e realizuara për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë 3. Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit 4. Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen 5. Kërkesa minimale për Veglat, hapësirat ose pajisjet teknike 6. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit). 2. Operatori Ekonomik duhet ta prezantoi listën e implementimit të projekteve të ngjashme që lidhën me prodhime të rotorëve te pompave furnizuese të kaldatajës, dhe instalime të tyre ne pompat furnizuese apo pompa te karakteristikave të ngjashme teknike. 3. Operatori Ekonomik, ne ofertën e tij, duhet të prezantoi stafin mbikëqyrës dhe stafin që do të angazhoji në vend punishte për fazën e demontimit dhe të instalimit të rotorëve të riinë te pompave furnizuese. Stafi duhet të jete i prezantuar me CV përkatëse. 4. Operatori Ekonomik, ne ofertën e vet, duhet të dëshmoi se posedon dokumentacionin teknik të detajuar me dimensione të punëtorisë dhe material të kërkuar për prodhimin rotorëve dhe pjesëve rezerve të kërkuara ne projekt 5. Operatori Ekonomik duhet ta deklaroi pajisjen të cilën do ta përdor për përmirësimin e sipërfaqes së brendshme të shtëpizës së pompave furnizuese si dhe stafin i cili do ta angazhoj të operoj me këtë pajisje. 6. Kopjet e Certifikatave të prodhuesit ISO 9001, 14001,
---	-----------	--	---

Po ashtu AK ne mënyrë te monologut aludon dhe pretendon se GOE ka apetit që te shpallet automatikisht si i përgjegjshëm dhe oferta te pranohet vetëm për shkak se është prodhues duke e favorizuar GOE.

Kjo është ne vijim te tendencave te AK që te arsyetoj me kokëfortësi shkeljet e njëpasnjëshme duke e keqpërdorur emrin dhe pozicionin e prodhuesit ne mënyrë te ulet dhe jo etike. E ne anën tjetër duke ja mohuar te drejtën e trajtimit te barabarte ne çdo pike.

Përgjigja e AK ne argumentin tone plotësues te ngritur ne kërkesën për rishqyrtim, vetëm se vërteton dyshimin tone si GOE, se vete AK ka intenca dhe është duke e shtyre procesin drejte një favorizimi për pale tjera te cilat vetëm se janë favorizuar me herët.

Nga me sipër dhe shtuar faktin se vete prodhuesi ka dhënë ende argumente plotësuese ne kërkesën për rishqyrtim. E duke pare se AK ka vendosur që me ngulmë te mbroje shkeljet e bera njëpasnjëshme gjate trajtimit te kësaj lende, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i

Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, e bazuar ankesa e grupit të GOE “Bilfinger Thermeq B.V.; ZILONIS Energy Solutions GmbH; AVK Power.
- II. **ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së për tenderuesin e eliminuar.
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

1,000,000.00 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*